



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM  
Nr.61, datë 29.04.2020**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM  
TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME POGRADEC**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (*ligji nr. 8102*), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura*" (*Vendimi nr. 40*), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura*" (*Vendimi nr. 41*), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "*Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura*" (*Vendimi nr. 42*),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 29.04.2020 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

**Konstatoi se:**

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Pogradec është licencuar me vendimin e KKRR Nr. 5, datë 03.02.2017, "*Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Pogradec*" pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "*Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*".

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Pogradec ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 170 prot. datë 10.04.2020, me lëndë "*Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura*" bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK është plotësuar konform Metodologjisë së Vendosjes së tarifave

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Pogradec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

### **VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Pogradec për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Pogradec për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Ndriçim Shani**